**VENDIM**
**Nr. 81/2017**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 46/2017 "PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT** AD HOC **ME 6 ANËTARË TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT, SIPAS LIGJIT NR. 84/2016, "PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 74/2017**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 9, pika 3, shkronjat "a" dhe "b", të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017 "Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit, sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 46/2017 "Për krijimin e Komisionit Parlamentar *ad hoc* me 6 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" bëhet kjo shtesë:

I. Pas pikës II/1 shtohet pika II/2 me këtë përmbajtje:

"II/2. Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni *ad hoc* caktohen deputetët:

1. Musa Ulqini (PS)
2. Helidon Bushati (PD)
3. Silva Caka (LSI)".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 17.6.2017